



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 404 Prot.

Tiranë, më datë 06.08.2018

VENDIM

Nr. 357, datë 27.07.2018

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RESTAURIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 71, pika 1 dhe neni 72, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.07.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit me objekt: “Restaurimi i ndërtesës së korpusit kryesor të Universitetit të Arteve”, kërkesë e Universitetit të Arteve, me kusht që të sigurohet;
 - Të mos ketë mbivendosje me punimet e realizuara në zbatimin e projektit të Ministrisë së Kulturës me objekt: Ndërhyrje rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza”, zhvilluar në vitin 2014 – 2015;
 - Pastrimi i fasadës (pllakat me travertinë), në pjesët e nevojshme, të realizohet me larje me avull;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 2;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Daniel Pirushi

KRYETAR

Mirela KUMBARO FURXHI

